

PROJEKTLIGJ
PËR SHËRBIMET E KUJDESIT SOCIAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU I
FUSHA E ZBATIMIT

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka si qëllim përcaktimin e rregullave për organizimin, financimin, sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale, si dhe përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi të institucioneve përkatëse, me synim garantimin e aksesit universal dhe përfshirjen sociale.

Neni 2
Fusha e zbatimit

Ky ligj përcakton:

- a) të drejtat dhe përgjegjësitë e përfituesve të shërbimeve të kujdesit social;
- b) përgjegjësitë e organeve të qeverisjes qendrore dhe vendore në planifikimin, financimin dhe ofrimin e shërbimeve;
- c) organizimin dhe funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit social;
- ç) kategoritë dhe llojet e shërbimeve
- d) standardet e cilësisë, monitorimin dhe inspektimin e shërbimeve;
- dh) rolin e ofruesve publikë dhe jopublikë të shërbimeve;
- e) organizimin dhe zhvillimin e forcës së punës në shërbimet e kujdesit social;
- ë) sistemin e informacionit dhe mekanizmat e koordinimit ndërinstitutional në fushën e kujdesit social.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Asistenca personale" është një shërbim i individualizuar mbështetës, i drejtuar dhe i kontrolluar nga personi me aftësi të kufizuara, i cili ofrohet për të mundësuar jetesën e pavarur, zgjedhjen, vetëvendosjen dhe pjesëmarrjen e plotë e efektive në komunitet, në përputhje me nevojat dhe preferencat individuale të tij.
2. "Familje kujdestare" është një familje alternative, e vendosur nga gjykata për t'i ofruar fëmijës një mjedis familjar, kushte për mirëritje, përkujdesje fizike dhe mbështetje emocionale sipas përcaktimeve të Kodit të Familjes.
3. "Grupe në nevojë" janë individët ose grupet e popullsisë që, për shkak të kushteve ekonomike, sociale, shëndetësore, familjare, moshës, aftësisë së kufizuar ose faktorëve të tjerë,

kanë nevojë për mbështetje të veçantë për garantimin e ushtrimit të të drejtave, autonomisë, mirëqenies dhe përfshirjes sociale.

4. “Kujdesi afatgjatë” është tërësia e shërbimeve dhe mbështetjeje të vazhdueshme që u ofrohen për një periudhë të zgjatur kohore individëve me humbje të pjesshme ose të plotë të autonomisë funksionale, për shkak të moshës, aftësisë së kufizuar, sëmundjes ose kushteve të tjera që kufizojnë pavarësinë e tyre.

5. “Kujdesi alternativ” është çdo formë e shërbimit të përkujdesit alternativ që i ofrohet një fëmije pa kujdes prindëror në përputhje me legjislacionin në fuqi për kujdesin alternativ në familje.

6. “Kujdesi informal” është kujdesi dhe mbështetja e ofruar në mënyrë të papaguar nga familjarët, të afërmit, miqtë ose persona të tjerë të lidhur me përfituesin, jashtë kuadrit të ofrimit profesional të shërbimeve sociale.

7. “Kujdesi zëvendësues i përkohshëm (respite care)” është një shërbim i përkohshëm që siguron kujdes dhe mbështetje për përfituesin, me qëllim lehtësimin e ngarkesës fizike, emocionale ose psikologjike të kujdestarit të tij.

8. “Kujdestar i shërbimit afatgjatë” është personi i trajnuar që ofron kujdes të drejtpërdrejtë dhe asistencë në aktivitetet e jetës së përditshme për individët në nevojë për kujdes afatgjatë, në shërbime rezidenciale, komunitare ose në banesë, ku përfshihen: kujdestar në banesë për të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuar, kujdestar në qendra rezidenciale, operatori social.

9. “Kujdestar ligjor” është individ i cili ofron shërbime kujdestarie për të miturit sipas përcaktimeve në Kodin e Familjes.

10. “Licencë” është akti administrativ i lëshuar nga një organ publik, që i jep një subjekti të drejtën për të ushtruar një veprimtari të caktuar, pasi ky subjekt ka përmbushur kushtet dhe kriteret e përcaktuara në legjislacion.

11. “Manaxhimi i Sistemeve të Informacionit (MIS) të Shërbimeve të Kujdesit Social” është administrimi profesional i të dhënave dhe informacionit që ndihmon në ofrimin e shërbimeve sociale të sigurta, efektive dhe të bazuara në nevojat reale të përfituesve.

12. “Ndihmësi personal” është personi i zgjedhur, i udhëzuar dhe, sipas mënyrës së organizimit të shërbimit, i mbikëqyrur nga personi me aftësi të kufizuara për të ofruar asistencë personale, në përputhje me nevojat, zgjedhjet dhe preferencat e këtij të fundit.

13. “Ofrues jopublik i shërbimeve sociale” është personi juridik privat, përfshirë organizatë jofitimprurëse, vendase ose e huaj, e licencuar, që ofron shërbime sociale në përputhje me procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

14. “Ofrues publik i shërbimeve sociale” është çdo institucion, strukturë e krijuar dhe financuar nga buxheti qendror i shtetit ose nga buxheti i njësisë të vetëqeverisjes vendore, që ofron shërbime sociale, të licencuara dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi të shërbimeve sociale.

15. “Psikolog” është profesionisti sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për Urdhrin e Psikologut.

16. “Punonjës i shërbimeve sociale” është i punësuar në shërbim të kategorive përfituese të shërbimeve të kujdesit social, si pjesë e sistemit publik dhe jopublik të ofrimit të shërbimeve të kujdesit social, i cili kontribuon në ofrimin ose mbështetjen e ofrimit të shërbimeve sociale, në përputhje me funksionet, përgjegjësitë dhe kërkesat profesionale përkatëse.

17. “Punonjës Social” është profesionisti sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për Urdhrin e Punonjësit Social.

18. "Punonjës i shërbimeve sociale" është çdo person i punësuar nga një ofrues publik ose jopublik i shërbimeve të kujdesit shoqëror, i cili ushtron funksione profesionale, teknike, administrative ose mbështetëse në ofrimin e këtyre shërbimeve.
19. "Shërbime komunitare" janë shërbime të kujdesit social që ofrohen në komunitet dhe synojnë mbështetjen e individëve për të jetuar në mënyrë të pavarur, për të ruajtur lidhjet familjare dhe për t'u përfshirë në jetën shoqërore.
20. "Shërbime emergjente" janë shërbime të menjëhershme dhe afatshkurtra që ofrohen në situata krize ose rreziku, me qëllim garantimin e sigurisë, mbrojtjes dhe mbështetjes së përfituesit.
21. "Shërbime multidisiplinare" janë shërbime të ofruara nga ekipe profesionistësh me formime dhe kompetenca të ndryshme, që bashkëpunojnë për vlerësimin, planifikimin dhe ofrimin e mbështetjes për përfituesin.
22. "Shërbime multifunksionale të kujdesit social" janë shërbime që kombinojnë dhe ofrojnë njëkohësisht disa forma mbështetjeje sociale, edukative, rehabilituese, këshillimore ose mbrojtëse, nëpërmjet një strukture ose mekanizmi të integruar.
23. "Shërbime në distancë" janë shërbime të kujdesit social që ofrohen përmes linjës telefonike, platformave digjitale ose mjeteve të tjera të komunikimit elektronik, pa praninë fizike të ofruesit dhe përfituesit, duke garantuar mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtat e përfituesve.
24. "Shërbime në familje" janë shërbime të kujdesit social që ofrohen në banesën e përfituesit ose në mjedisin familjar të tij, me qëllim ruajtjen e funksionalitetit, autonomisë dhe mirëqenies së individit.
25. "Shërbime mbështetëse sociale" janë shërbime profesionale të kujdesit social që ofrohen në komunitet ose në banesën e përfituesit dhe synojnë ruajtjen ose zhvillimin e autonomisë, aftësive funksionale, jetesës së pavarur, përfshirjes sociale dhe pjesëmarrjes aktive të individit në jetën e komunitetit, nëpërmjet mbështetjes individuale të përshtatur sipas nevojave të përfituesit.
26. "Shërbime rezidenciale" janë shërbime të kujdesit social që ofrojnë akomodim dhe përkujdesje të vazhdueshme të përfituesve, për një periudhë afatshkurtër ose afatgjatë, sipas nevojave të tyre.
27. "Shërbime të integruara" janë shërbime të planifikuara dhe të ofruara në mënyrë të koordinuar ndërmjet sektorëve socialë, shëndetësorë, arsimorë, të punësimit dhe sektorëve të tjerë relevantë, në bazë të një plani të përbashkët ndërhyrjeje, me qëllim ofrimin e mbështetjes së vazhdueshme dhe të personalizuar për përfituesit.
28. "Shërbime të kujdesit social" janë tërësia e ndërhyrjeve profesionale, mbështetëse, rehabilituese, mbrojtëse dhe zhvilluese të organizuara nga ofrues publikë ose jopublikë, që synojnë përmirësimin e mirëqenies, autonomisë funksionale, përfshirjes sociale, mbrojtjes së të drejtave dhe cilësisë së jetës së individëve, familjeve dhe grupeve në nevojë.
29. "Shërbime të specializuara" janë shërbime që adresojnë nevoja komplekse ose specifike, synojnë trajtimin, rehabilitimin ose mbështetjen e individëve dhe ofrohen nga profesionistë me kompetenca të specializuara.
30. "Shërbime tranzitore" janë shërbime që mbështesin kalimin e përfituesit nga një formë kujdesi ose mbështetjeje në një tjetër, përfshirë kalimin drejt jetesës së pavarur dhe përfshirjes në komunitet.
31. "Shërbimet lëvizëse" janë shërbime të kujdesit social, që ofrohen në komunitet ose në vendbanimin e përfituesve nga ekipe profesionale që lëvizin në terren, me qëllim identifikimin e nevojave dhe ofrimin e mbështetjes psiko-sociale, këshillimit dhe asistencës për individët dhe familjet në situata vulnerabël, si dhe referimin e tyre drejt shërbimeve përkatëse.
32. "Standardi i cilësisë së shërbimeve" është një grup kërkesash, kriteresh dhe rregullash që përcaktojnë nivelin minimal të cilësisë, që duhet të plotësojnë shërbimet e kujdesit social për

të garantuar ofrimin e tyre në mënyrë të sigurt, efektive dhe në përputhje me nevojat e përfituesve.

33. "Sistemi Elektronik i Informacionit për Shërbimet e Kujdesit Social" është infrastruktura kombëtare e informacionit që përfshin, ndër të tjera, Regjistrin Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Social dhe funksionalitete të tjera për menaxhimin, monitorimin dhe raportimin e sistemit.

Neni 4 Parimet

1. Shërbimet sociale administrohen në bazë të parimeve universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë në bazë të këtyre parimeve themelore:

a) universalitetit, sipas të cilit çdo person që plotëson kushtet e përcaktuara me ligj gëzon akses të barabartë në shërbimet e kujdesit social;

b) drejtësisë sociale, sipas të cilit shërbimet kontribuojnë në reduktimin e varfërisë, përjashtimit social dhe pabarazive;

c) subsidiaritetit, sipas të cilit shërbimet ofrohen sa më pranë përfituesit dhe, kur është e mundur, në nivel komunitar dhe vendor;

ç) mbështetjes sociale, sipas të cilit individët dhe familjet në nevojë kanë të drejtë të përfitojnë shërbime sociale në përputhje me legjislacionin në fuqi;

d) deinstitutionalizimit, sipas të cilit kujdesi dhe mbështetja ofrohen, për aq sa është e mundur, në familje dhe komunitet, duke shmangur institucionalizimin e panevojshëm;

dh) partneritetit, sipas të cilit sistemi i shërbimeve sociale bazohet në bashkëpunimin ndërmjet institucioneve publike, organizatave jofitimprurëse, sektorit privat dhe aktorëve të tjerë relevantë;

e) respektimit të të drejtave të njeriut, dinjitetit, integritetit, autonomisë dhe fuqizimit të përfituesit, sipas të cilit shërbimet synojnë rritjen e aftësisë së individit për të marrë vendime të informuara, për të jetuar në mënyrë të pavarur dhe për të marrë pjesë aktivisht në jetën e komunitetit.

ë) mosdiskriminimit, sipas të cilit ndalohet çdo formë diskriminimi në aksesin dhe përfitimin e shërbimeve sociale;

f) konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi;

g) decentralizimit, sipas të cilit përgjegjësitë dhe kompetencat për planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale ushtrohen sa më afër komunitetit;

gj) pjesëmarrjes së përfituesit, sipas të cilit përfituesit përfshihen në vlerësimin e nevojave, planifikimin dhe monitorimin e shërbimeve që u ofrohen;

h) barazisë dhe paanshmërisë, sipas të cilit shërbimet ofrohen në mënyrë të drejtë, objektive dhe në respekt të dinjitetit të çdo individi;

i) integritit dhe koordinimit ndërsektorial, sipas të cilit sigurohet bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet sektorit social, shëndetësor, arsimor, të punësimit dhe sektorëve, shërbimeve dhe aktorëve të tjerë relevantë, me qëllim ofrimin e mbështetjes së koordinuar, gjithëpërfshirëse dhe të vazhdueshme, në përputhje me nevojat individuale të përfituesit;

j) cilësisë dhe përshtatjes së shërbimeve, sipas të cilit shërbimet e kujdesit social planifikohen, organizohen dhe ofrohen në përputhje me standardet e miratuara dhe bazuar në nevojat individuale të përfituesit, duke garantuar efektivitetin, vazhdimësinë, sigurinë,

aksesueshmërinë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së tyre, përfshirë, sipas rastit, ofrimin e shërbimeve afatshkurtra.

KREU II

PËRFITUESIT DHE AKSESI NË SHËRBIME

Neni 5

Përfituesit

1. Të drejtën për të përfitur shërbime të kujdesit social e kanë individët, familjet dhe grupet në situatë vulnerabiliteti, të cilët, për shkak të moshës, aftësisë së kufizuar, gjendjes shëndetësore, situatës familjare, ekspozimit ndaj dhunës, përjashtimit social ose kushteve të tjera të cenueshmërisë, vlerësohen si në nevojë për shërbime të kujdesit social, në përputhje me nevojat individuale të përfituesit, këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Përfitimi i shërbimeve të kujdesit social realizohet mbi bazën e vlerësimit të nevojës dhe nivelit të cenueshmërisë sociale, të kryer nga struktura përgjegjëse në nivel vendor ose qendror, sipas kompetencave të përcaktuara me ligj.
3. Përfitues të shërbimeve të kujdesit social përfshijnë, por nuk kufizohen në:
 - a) fëmijët në nevojë për mbrojtje të veçantë;
 - b) fëmijët pa kujdes prindëror;
 - c) fëmijët në konflikt me ligjin;
 - ç) fëmijët e pashoqëruar;
 - d) personat me aftësi të kufizuara;
 - dh) të moshuarit;
 - e) viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore;
 - ë) viktimat e trafikimit;
 - f) familjet në nevojë;
 - g) individët në situata të tjera të cenueshmërisë sociale.
4. Çdo individ në territorin e Republikës së Shqipërisë ka të drejtë të aksesojë shërbimet emergjente të kujdesit social, në rast nevoje dhe cenueshmërie, pavarësisht statusit juridik, moshës, gjinisë apo gjendjes socio-ekonomike.
5. Në rastet kur përfituesit janë subjekt i regjimeve të veçanta ligjore, aksesit në shërbimet e kujdesit social rregullohet sipas legjislacionit përkatës.
6. Këshilli i Ministrave përcakton rastet e veçanta dhe të justifikuara, për të cilat zbatohen procedura të posaçme për aksesin në shërbimet e kujdesit social, si dhe rregullat përkatëse për zbatimin e tyre.
7. Në raste emergjente ose të justifikuara individualisht, struktura përgjegjëse për shërbimet e kujdesit social në nivel vendor ose qendror lejojnë devijim nga procedurat standarde të aksesit, me vendim të motivuar me shkrim, në përputhje me parimet e këtij ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 6

Të drejtat e përfituesve

1. Përfituesit e shërbimeve të kujdesit social gëzojnë këto të drejta:

- a) të trajtohen me dinjitet, respekt dhe pa diskriminim, duke respektuar integritetin fizik dhe psikologjik, jetën private dhe familjare, intimitetin, sigurinë dhe lirinë e lëvizjes, në përputhje me kufizimet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi;
- b) të marrin informacion të plotë, të qartë, të kuptueshëm dhe të aksesueshëm mbi:
 - shërbimet që u ofrohen;
 - kriteret dhe procedurat e përfitimit të tyre;
 - të drejtat dhe detyrimet e tyre;
 - mënyrat e paraqitjes së ankesave;
 - dokumentacionin që lidhet me kujdesin dhe mbështetjen e tyre;
- c) të marrin pjesë në vlerësimin e nevojave, planifikimin, zbatimin, rishikimin dhe vendimmarrjen lidhur me shërbimet që u ofrohen, drejtpërdrejt ose, sipas rastit, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor apo personit të autorizuar;
- ç) të kërkojnë korrigjimin ose plotësimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale;
- d) të gëzojnë mbrojtjen e privatësisë dhe konfidencialitetit të të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale;
- dh) të marrin shërbime cilësore, të sigurt, të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave të tyre individuale;
- e) të paraqesin ankesa, kërkesa ose sugjerime lidhur me shërbimet e ofruara dhe të marrin përgjigje brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, pa u cenuar për këtë shkak e drejta për të përfituar shërbimin.
- ë) të kenë akses të barabartë në shërbime, bazuar në vlerësimin e nevojave individuale dhe pa asnjë formë diskriminimi;
- f) të mbrohen nga çdo formë dhune, abuzimi, neglizhence, shfrytëzimi, trajtimi çnjerëzor ose degradues dhe diskriminimi;
- g) të marrin pjesë, individualisht ose nëpërmjet organizatave përfaqësuese, në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve sociale;
- gj) të përfitojnë shërbime të koordinuara dhe të integruara sociale, shëndetësore, arsimore, rehabilituese dhe shërbime të tjera, sipas nevojave të tyre;
- h) të marrin mbështetje të përshtatur sipas nevojave specifike dhe karakteristikave individuale, duke përfshirë fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, viktimat e dhunës, viktimat e trafikimit dhe grupet e tjera në nevojë;
- i) të gëzojnë mbrojtje efektive administrative dhe gjyqësore në rast të cenimit të të drejtave të tyre.

Neni 7

Detyrimet e përfituesve të shërbimeve të kujdesit social

1. Përfituesit e shërbimeve të kujdesit social, në përputhje me aftësitë, moshën dhe gjendjen e tyre shëndetësore, kanë këto detyrime:

- a) të bashkëpunojnë me ofruesin e shërbimit dhe profesionistët përgjegjës në vlerësimin e nevojave dhe hartimin e planit individual të mbështetjes;

- b) të japin informacion të saktë dhe të plotë për rrethanat që lidhen me ofrimin e shërbimit, kur ky informacion është i nevojshëm për vlerësimin e nevojave dhe ofrimin e tij;
 - c) të njoftojnë ofruesin e shërbimit për çdo ndryshim të rëndësishëm që ndikon në përfitimin ose ofrimin e shërbimit, sipas rasteve të parashikuara në këtë ligj;
 - ç) të respektojnë dinjitetin, të drejtat dhe integritetin e përfituesve të tjerë dhe të personelit të ofruesit të shërbimit;
 - d) të respektojnë rregullat e funksionimit të shërbimit, për aq sa ato janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nuk cenojnë të drejtat e tyre;
 - dh) të përdorin me kujdes ambientet, pajisjet dhe mjetet e vëna në dispozicion gjatë ofrimit të shërbimit;
 - e) të kontribuojnë në zbatimin e planit individual të mbështetjes, sipas mundësive dhe kapaciteteve të tyre.
2. Ushtrimi i këtyre detyrimeve nuk mund të përdoret si shkak për kufizimin ose mohimin e të drejtave të përfituesit, përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe në ligj.

PJESA E DYTË

MEKANIZMAT INTSITUCIONALE DHE KOORDINIMI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SOCIAL.

KREU I

ROLET DHE PËRGJEGJËSITË

Neni 8

Sistemi i shërbimeve të kujdesit social

1. Sistemi i shërbimeve të kujdesit social organizohet mbi parimin e bashkëpunimit ndërmjet organeve të pushtetit qendror, organeve të vetëqeverisjes vendore dhe ofruesve të shërbimeve, me qëllim garantimin e planifikimit, ofrimit, monitorimit dhe zhvillimit të shërbimeve të integruara në territor.
2. Përgjegjësitë në kuadër të sistemit ndahen si më poshtë:
 - a) organet e pushtetit qendror përcaktojnë politikën, standardet dhe kuadrin rregullator të shërbimeve të kujdesit social, si dhe sigurojnë mekanizmat financiarë dhe monitorimin në nivel kombëtar;
 - b) organet e vetëqeverisjes vendore janë përgjegjëse për vlerësimin e nevojave, planifikimin, organizimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit social në territorin e tyre;
 - c) ofruesit e shërbimeve të kujdesit social ofrojnë shërbime në përputhje me standardet kombëtare të cilësisë dhe legjislacionin në fuqi;
 - ç) mekanizmat e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional sigurojnë ndërveprimin efektiv ndërmjet aktorëve të sistemit.
3. Në nivel qendror, funksionet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni ushtrohen nga:
 - a) ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
 - b) agjencia përgjegjëse për shërbimet sociale;
 - c) institucionet e tjera qendrore, sipas kompetencave të përcaktuara me ligj.

4. Në nivel vendor, funksionet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni ushtrohen nga organet e vetëqeverisjes vendore përmes strukturave përgjegjëse për planifikimin, ofrimin, koordinimin dhe monitorimin e shërbimeve në nivel vendor .

5. Ofruesit e shërbimeve të kujdesit social janë persona juridikë publikë ose jopublikë, të licencuar sipas legjislacionit në fuqi.

6. Ofruesit e shërbimeve të kujdesit social ndahen në:

a) ofrues publikë, të krijuar dhe financuar nga pushteti qendror ose organet e vetëqeverisjes vendore;

b) ofrues jopublikë, që nuk bëjnë pjesë në sektorin publik dhe ofrojnë shërbime në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Ofruesit jopublikë përfshijnë:

a) organizatat jofitimprurëse;

b) organizatat fetare;

c) shoqëritë tregtare dhe subjektet e tjera private të licencuara për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social.

8. Ofruesit jopublikë mund të ofrojnë shërbime me ose pa pagesë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, kushtet e licencimit dhe standardet kombëtare të cilësisë.

KREU II

ORGANET NË NIVEL QENDROR

Neni 9

Ministria përgjegjëse për çështjet sociale

1. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale është autoriteti përgjegjës për hartimin e politikave, kuadrit ligjor dhe rregullator, planifikimin strategjik dhe mbikëqyrjen e sistemit të shërbimeve të kujdesit social në nivel kombëtar.

2. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale ka këto role dhe funksione kryesore:

a) Harton, propozon dhe koordinon dokumente politike, strategji dhe programe për reformimin dhe modernizimin e sistemit të shërbimeve sociale, duke synuar rritjen e efektivitetit dhe përmirësimin e cilësisë;

b) Koordinon zbatimin e politikave në nivel qendror dhe vendor, duke siguruar integrimin e sistemit;

c) Harton, përditëson dhe mbikqyr zbatimin e standardeve bazë të cilësisë së shërbimeve sociale;

d) Propozon dhe harton akte ligjore dhe nënligjore për plotësimin e kuadrit rregullator të sistemit;

e) Përcakton kriteret dhe kushtet për licencimin e subjekteve publike dhe jopublike për ofrimin e shërbimeve sociale;

f) Ndërmerr fushata ndërgjegjësimi për nxitjen e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale të individëve , familjeve dhe grupeve në nevojë;

g) Harton dhe ndjek zbatueshmërinë e marrëveshjeve të bashkëpunimit midis aktorëve të përfshirë në sistemin e shërbimeve;

h) Programon dhe menaxhon fondet për shërbimet sociale, përfshirë transfertat në bashki;

i) Harton dhe monitoron instrumentet për njësitë e vetëqeverisjes vendore mbi strukturat,

planifikimin, financimin dhe ofrimin e shërbimeve;

j) Harton dhe koordinon politikat për integrimin dhe ndërveprimin ndërmjet skemave të mbrojtjes sociale me përfitime financiare dhe sistemit të shërbimeve të kujdesit social, me qëllim garantimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes sociale;

k) Koordinon administrimin dhe mbikëqyrjen e sistemit kombëtar të informacionit dhe referimit të rasteve.

Neni 10

Agjencia përgjegjëse për shërbimet kujdesit social

1. Agjencia përgjegjëse për shërbimet kujdesit social është institucion në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, i cili mbështet zbatimin e politikave dhe siguron monitorimin dhe zhvillimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit social në nivel kombëtar dhe vendor.

2. Statuti i Agjencisë përgjegjëse për shërbimet e kujdesit social miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Struktura dhe organika e Agjencisë përgjegjëse për shërbimet e kujdesit social miratohet me urdhër të Kryeministrit.

4. Agjencia përgjegjëse për shërbimet e kujdesit social monitoron zbatimin e legjislacionit të shërbimeve sociale në të gjithë vendin, nëpërmjet strukturave të njësive qendrore dhe drejtorive rajonale.

5. Agjencia përgjegjëse për shërbimet e kujdesit social ka këto role dhe funksione kryesore:

a) kryen vlerësimin dhe hartëzimin e nevojave të shërbimeve të kujdesit social në nivel kombëtar dhe vendor, ku përfshihet dhe vlerësimi i nevojave për shërbime të perkujdesit shoqëror dhe kapaciteteve të shërbimeve publike e jopublike

b) mbledh, analizon dhe përpunon informacionin mbi ecurinë e sistemit të shërbimeve të kujdesit social dhe raporton periodikisht në ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale;

ç) identifikon nevojat për ngritjen e kapaciteteve të personelit të sistemit të shërbimeve të kujdesit social, harton programet vjetore të trajnimit dhe koordinon organizimin e tyre, në bashkëpunim me institucionet publike, institucionet e arsimit të lartë, partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë dhe subjektet e tjera të specializuara;

d) bashkërendon procesin e hartimit të planeve sociale vendore, duke siguruar që këto plane të përputhen me politikat, strategjitë dhe programet kombëtare, si dhe me analizën e nevojave;

dh) administron, përditëson dhe mirëmban Regjistrin Elektronik Kombëtar me të dhënat për përfituesit dhe subjektet ofruese të kujdesit social;

e) përgatit dhe paraqet pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale statistikën dhe analizat në lidhje me shërbimet e kujdesit social;

f) siguron mekanizma efektivë për marrjen e ankesave dhe vlerësimin e kënaqësisë së përfituesve, si dhe garanton transparencën përmes publikimit periodik të rezultateve të monitorimit dhe statistikave sociale;

g) monitoron zbatimin e standardeve në fushën e shërbimeve të kujdesit social në të gjithë territorin, sipas një metodologjie të miratuar dhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

h) vlerëson performancën e ofruesve të shërbimeve në bazë të indikatorëve të cilësisë dhe rezultateve të monitorimit.

Neni 11

Struktura përgjegjëse për inspektimin e shërbimeve të kujdesit social

1. Struktura përgjegjëse për inspektimin e shërbimeve të kujdesit social ushtron funksionet e saj në mënyrë të pavarur funksionale, në përputhje me legjislacionin për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.
2. Struktura përgjegjëse për inspektimin e shërbimeve të kujdesit social kryen funksionet e mëposhtme:
 - a) Verifikon përputhshmërinë e ofruesve të shërbimeve publike dhe jopublike të kujdesit social, me dispozitat e këtij ligji.
 - b) Inspekton kushtet në të cilat ofrohen shërbimet e kujdesit social, duke përfshirë respektimin e standardeve të miratuara;
 - c) Kryen inspektime të ambienteve, aktiviteteve dhe dokumentacionit të ofruesve të shërbimeve të kujdesit social, të cilat duhet të japin akses në informacionin e nevojshëm për kryerjen e inspektimeve;
 - ç) Kërkojnë masa korrigjuese për të ndrequr mospërputhshmërinë e identifikuar;
 - d) vendos masa dhe sanksione administrative në përputhje me ligjin;
 - dh) propozon pezullimin ose revokimin e licencave të ofruesve të shërbimeve të kujdesit social, në përputhje me këtë ligj;
 - e) bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion me autoritete të tjera kompetent;
 - ë) raporton periodikisht në ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale mbi rezultatet e inspektimeve.
3. Struktura përgjegjëse për inspektimet e shërbimeve të kujdesit social, shqyrton ankesat kundër subjekteve që ofrojnë shërbime të kujdesit social, të marra drejtpërdrejt ose të dërguara nga çdo institucion ose individ tjetër.
4. Struktura përgjegjëse për inspektimet e kujdesit social nxjerr një vendim, pas shqyrtimit të ankesave, në përputhje me Ligjin për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë.
5. Procedurat për inspektimin, përfshirë rregulloren për shqyrtimin dhe trajtimin e ankesave nga struktura përgjegjëse për inspektimin e kujdesit social, miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

KREU III

ORGANET NË NIVEL VENDOR

Neni 12

Qarku

1. Qarku është njësi e nivelit të dytë të vetëqeverisjes vendore që ushtron funksione të koordinimit, planifikimit strategjik dhe mbështetjes për zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit social në territorin e tij, në përputhje me politikat kombëtare dhe standardet europiane. Qarku siguron koordinimin e politikave të kujdesit social në nivel rajonal dhe garanton koherencën e sistemit të shërbimeve të kujdesit social brenda territorit të tij.

2. Këshilli i qarkut miraton planin social rajonal, në bazë të planeve sociale të bashkive, dhe siguron përputhshmërinë e tij me politikat dhe prioritetet kombëtare të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.
3. Qarku mbështet dhe lehtëson bashkëpunimin midis bashkive për planifikimin dhe organizimin e shërbimeve të kujdesit social.
4. Kur plotësohen kushtet e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, qarku, për të siguruar mbulim efektiv të nevojave për shërbime të kujdesit social dhe përdorim efikas të burimeve financiare, njerëzore dhe infrastrukturore, organizon dhe koordinon ofrimin e shërbimeve me karakter ndërbashkiak ose rajonal, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore.
5. Qarku, kur është e nevojshme firmos marrëveshje direkte bashkëpunimi me OJF të specializuara për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social.
6. Për qëllime planifikimi dhe koordinimi, Kryetari i Qarkut krijon një mekanizëm koordinimi rajonal që bashkon përfaqësues të njësive të qeverisjes vendore, institucioneve publike përkatëse dhe organizatave të shoqërisë civile.

Neni 13 Bashkia

1. Bashkia është përgjegjëse për zbatimin e politikave të kujdesit social në nivel vendor dhe garanton akses të barabartë në shërbimet e kujdesit social për të gjithë popullsinë brenda territorit të saj.
2. Bashkia përcakton, planifikon, organizon, financon dhe siguron ofrimin e shërbimeve të kujdesit social, bazuar në vlerësimin e nevojave të komunitetit, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në fuqi.
3. Në ushtrimin e funksioneve të saj, bashkia:
 - a) identifikon dhe vlerëson periodikisht nevojat e popullsisë për shërbime të kujdesit social, bazuar në hartën e vulnerabilitetit, të dhënat e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NJVNR), burime të tjera zyrtare të të dhënave, si dhe hartëzimin e shërbimeve ekzistuese në territor;
 - b) harton dhe miraton Planin Social Vendor;
 - c) planifikon dhe administron buxhetet vendore për shërbimet e kujdesit social;
 - ç) përcakton paketën vendore të shërbimeve të kujdesit social, në përputhje me standardet dhe shportën bazë të shërbimeve të përcaktuara në nenin xxx të këtij ligji.
 - d) siguron ofrimin e shërbimeve, drejtpërdrejt ose përmes kontraktimit të ofruesve të licencuar, në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik;
 - dh) siguron monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të kujdesit social.
 - e) masat për zhvillimin e kapaciteteve institucionale dhe burimeve njerëzore për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social.
4. Plani Social Vendor është dokumenti strategjik për zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social në nivel vendor. Ai hartohet nga bashkia në përputhje me metodologjinë e miratuar nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe përmban, të paktën:

- a) analizën e nevojave dhe hartën e vulnerabilitetit;
 - b) prioritetet dhe objektivat;
 - c) shportën bazë të shërbimeve;
 - ç) planin financiar;
 - d) treguesit e monitorimit dhe vlerësimit.
5. Plani Social Vendor miratohet nga këshilli bashkiak dhe rishikohet në përputhje me ciklin e planifikimit buxhetor vendor.
 6. Bashkia krijon dhe administron Fondin Social Vendor si instrument financiar për financimin e shërbimeve të kujdesit social. Fondi Social Vendor përbëhet nga:
 - a) fondet e buxhetit vendor;
 - b) transfertat specifike dhe të pakushtëzuara nga buxheti i shtetit;
 - c) fondet e akorduara në kuadër të programeve kombëtare për shërbimet e kujdesit social, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave;
 - ç) donacione dhe burime të tjera të ligjshme.
 7. Fondi Social Vendor përdoret për:
 - a) financimin e shërbimeve ekzistuese të kujdesit social;
 - b) ngritjen dhe zhvillimin e shërbimeve të reja, në përputhje me planin social vendor;
 - c) kontraktimin e organizatave jofitimprurëse dhe ofruesve të tjerë të licencuar;
 - ç) mbështetjen e programeve dhe ndërhyrjeve inovative në fushën e shërbimeve sociale.
 8. Për administrimin, koordinimin dhe zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social, bashkitë krijojnë strukturat përgjegjëse për shërbimet sociale, në përputhje me legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes vendore.
 9. Pranë çdo njësie administrative, në varësi të bashkisë, ngrihet dhe funksionon Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit.
 10. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi për ngritjen dhe administrimin e përbashkët të shërbimeve të kujdesit social, me qëllim rritjen e aksesit, cilësisë dhe eficiencës së shërbimeve.
 11. Bashkitë mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi ose kontrata me organizata jofitimprurëse dhe ofrues të tjerë të licencuar për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 14

Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe referimit të rastit

1. Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit ngrihet pranë çdo njësie administrative, si strukturë teknike përgjegjëse për parandalimin, identifikimin proaktiv, vlerësimin e nevojave dhe referimin e rasteve për shërbime të kujdesit social
2. Njësia ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me parimet e barazisë, gjithëpërfshirjes, interesit më të mirë të përfituesit, konfidencialitetit dhe respektimit të dinjitetit njerëzor.
3. Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit përbëhet, të paktën, nga punonjësi social, administratorit social dhe punonjësit për mbrojtjen e fëmijës, sipas kompetencave dhe përgjegjësi të përcaktuara në legjislacionin përkatës.
3. Njësia e Vlerësimit të Nevojave ka këto detyra kryesore:
 - a) identifikon dhe vlerëson periodikisht nevojat sociale të individëve dhe familjeve në territorin e bashkisë, si dhe identifikon rastet në nevojë për mbrojtje;

- b) kryen vlerësimin fillestar dhe, sipas rastit, vlerësimin e thelluar të nevojave për shërbime të kujdesit social, sipas metodologjisë së menaxhimit të rastit dhe instrumenteve të miratuara;
 - c) rekomandon dhe koordinon aksesin në shërbimet e përshtatshme të kujdesit social, sipas nevojave të vlerësuara dhe planit individual të ndërhyrjes;
 - d) bashkëpunon me strukturat përgjegjëse për menaxhimin e rastit për hartimin, zbatimin dhe rishikimin e planit individual të ndërhyrjes;
 - e) vlerëson nivelin e riskut dhe përcakton prioritetin e ndërhyrjes, sipas instrumenteve dhe procedurave të miratuara;
 - ë) koordinon dhe lehtëson referimin e rasteve në shërbimet sociale të integruara dhe institucionet e tjera publike ose jopublike;
 - f) ndjek rastet e referuara dhe siguron monitorimin e vazhdueshëm të tyre, sipas procedurave të përcaktuara;
 - g) kontribuon në mbledhjen dhe analizën e të dhënave mbi nevojat sociale për qëllime planifikimi dhe zhvillimi të shërbimeve sociale në nivel vendor;
 - gj) mbështet bashkinë në hartimin dhe rishikimin e planit social vendor;
 - h) bashkëpunon me institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile dhe ofruesit e shërbimeve sociale për adresimin e nevojave të identifikuara.
4. Metodologjia e organizimit dhe funksionimit të Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit, standardet profesionale, procedurat e vlerësimit dhe referimit të rasteve, dokumentacioni standard dhe mënyra e bashkëpunimit ndërinstitutional miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

Neni 15

Ofruesit e shërbimeve të kujdesit social

1. Shërbimet e kujdesit social ofrohen nga ofrues publikë dhe jopublikë, të licencuar sipas legjislacionit në fuqi.
2. Ofruesit e shërbimeve të kujdesit social janë përgjegjës për:
 - a) ofrimin e shërbimeve në përputhje me standardet e cilësisë dhe protokollet profesionale;
 - b) respektimin e të drejtave dhe dinjitetit të përfituesve;
 - c) garantimin e mosdiskriminimit, konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale;
 - ç) bashkëpunimin me autoritetet dhe strukturat përgjegjëse për menaxhimin e rasteve, referimin dhe koordinimin e shërbimeve;
 - d) monitorimin dhe raportimin sipas kërkesave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.
3. Ofruesit e shërbimeve i nënshtrohen monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit nga autoritetet kompetente.

KREU IV

MEKANIZMI I KOORDINIMIT

Neni 16

Këshilli Kombëtar për Shërbimet e Kujdesit Social

1. Këshilli Kombëtar për Shërbimet e Kujdesit Social është organ këshillimor dhe koordinues ndërinstitutional, i cili mbështet zhvillimin e politikave dhe forcimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit social në Republikën e Shqipërisë.
2. Këshilli ka për qëllim:
 - a) të sigurojë koordinimin ndërinstitutional në fushën e shërbimeve të kujdesit social;
 - b) të japë rekomandime për politikat dhe prioritetet strategjike në këtë fushë;

c) të mbështesë koordinimin strategjik dhe harmonizimin e politikave ndërmjet institucioneve të nivelit qendror, njësive të vetëqeverisjes vendore dhe aktorëve të tjerë të sistemit të shërbimeve të kujdesit social.

3. Këshilli nuk ushtron funksione ekzekutive, financiare apo administrative në ofrimin e shërbimeve të kujdesit social.

4. Këshilli Kombëtar për Shërbimet e Kujdesit Social përbëhet nga:

- a) ministri përgjegjës për çështjet sociale, si kryetar;
- b) përfaqësues të ministrive përgjegjëse sipas fushave që lidhen me shërbimet e kujdesit social;
- c) drejtuesi i Agjencisë përgjegjëse për shërbimet e kujdesit social;
- ç) drejtuesi i Agjencisë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së shërbimeve sociale;
- d) përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore;
- dh) përfaqësues të ofruesve publikë dhe jopublikë të shërbimeve të kujdesit social;
- e) përfaqësues i Urdhrit të Punonjësve Socialë;
- ë) përfaqësues i Urdhrit të Psikologut;
- f) përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave të përfituesve të shërbimeve të kujdesit social.

5. Numri i anëtarëve, përfaqësues i institucioneve dhe organizatave, mënyra e emërimit të anëtarëve dhe rregullat e tjera të organizimit të Këshillit përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.

6. Rregullat për mënyrën e funksionimit, organizimin e mbledhjeve dhe çështje të tjera procedurale përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Këshilli.

PJESA E TRETË

SHËRBIMET E KUJDESIT SOCIAL DHE MËNYRAT E OFRIMIT TË TYRE

KREU I

ORGANIZIMI DHE STANDARDET E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SOCIAL

Neni 17

Kategoritë e shërbimeve të kujdesit social

1. Shërbimet e kujdesit social organizohen si një sistem i integruar i mbështetjes, mbrojtjes, përkujdesjes dhe fuqizimit të përfituesit, në funksion të garantimit të mirëqenies, përfshirjes sociale dhe jetesës së pavarur.

2. Shërbimet e kujdesit social organizohen dhe ofrohen duke i dhënë përparësi mbështetjes në familje dhe komunitet, sa herë që kjo është e mundur dhe në përputhje me interesin më të mirë të përfituesit.

3. Shërbimet e kujdesit social klasifikohen, sipas mjedisit kryesor të ofrimit të tyre, në kategoritë e mëposhtme:

- a) Shërbime rezidenciale, Shërbimet rezidenciale ofrohen kur mbështetja në familje ose komunitet nuk është e mjaftueshme ose nuk është në interesin më të mirë të përfituesit, të cilat përfshijnë çdo formë akomodimi dhe përkujdesjeje 24-orëshe, përfshirë shërbimet emergjente dhe manaxhimin të krizës, afatshkurtra, tranzitore (strehëzat) dhe afatgjata;

- b) Shërbime komunitare dhe në familje, të cilat ofrohen në komunitet ose në banesën e përfituesit, përfshirë këtu shërbimet mbështetëse, ditore, lëvizëse, në shtëpi dhe forma të tjera të mbështetjes në mjedisin ku jeton;
 - c) Shërbime në distancë, të cilat ofrohen pa praninë fizike të përfituesit dhe ofruesit, përmes telefonit, platformave digjitale ose mjeteve të tjera të komunikimit elektronik;
 - ç) Shërbime të kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror ose në rrezik të humbjes së tij, duke i dhënë përparësi parandalimit të ndarjes së fëmijës nga familja dhe, kur kjo nuk është e mundur, formave alternative të kujdesit, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës;
 - d) Shërbime të jetesës së pavarur dhe përfshirjes sociale, të cilat synojnë mbështetjen e individëve për të jetuar në mënyrë autonome dhe për të marrë pjesë aktive në jetën shoqërore, përfshirë asistencën personale dhe format e tjera të mbështetjes individuale.
4. Shërbimet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni ofrohen si shërbime të përgjithshme ose të specializuara, në varësi të kompleksitetit të nevojave të përfituesve dhe nivelit të ndërhyrjes së kërkuar.
5. Shërbimet e kujdesit social kanë funksione parandaluese, mbrojtëse, zhvilluese, rehabilituese, fuqizuese dhe mbështetëse, afatshkurtra ose afatgjata, sipas nevojave individuale të përfituesit.
6. Shërbimet e kujdesit social ofrohen në forma të integruara, multifunksionale, multidisiplinare dhe ndërsektoriale, në bashkërendim me shërbimet shëndetësore, arsimore, të punësimit, të strehimit, të mbrojtjes sociale, të drejtësisë, të ndihmës juridike falas dhe me sektorë të tjerë përkatës, sipas nevojave të përfituesit. Ato mund të përfshijnë edhe kujdesin zëvendësues të përkohshëm (respite care), mbështetjen për kujdestarët formalë dhe informalë, si dhe forma të tjera mbështetjeje të parashikuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
7. Kriteret dhe procedurat e pranimit, në të gjitha kategoritë dhe llojet e shërbimeve sociale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 18

Standardet bazë të cilësisë së shërbimeve të kujdesit social

1. Standardet bazë të cilësisë për shërbimet e kujdesit social përcaktojnë kërkesat minimale të detyrueshme për organizimin, funksionimin dhe ofrimin dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimeve e shërbimeve dhe përfshijnë, sipas llojit të shërbimit:
- a) përshkrimin e llojit të shërbimit, qëllimin e tij dhe grupin e synuar të përfituesve dhe kriteret e përfitimit;
 - b) garantimin e të drejtave, dinjitetit, sigurisë dhe mirëqenies së përfituesve, përfshirë mekanizmat e informimit, ankesave, mbrojtjes dhe pjesëmarrjes së tyre në vlerësimin dhe përmirësimin e shërbimeve;
 - c) garantimin e të drejtave, dinjitetit, sigurisë dhe mirëqenies së përfituesve, si dhe mekanizmat e ankesave dhe mbrojtjes së tyre;
 - ç) organizimin institucional, menaxhimin dhe procedurat e ofrimit të shërbimit;
 - d) kërkesat për burimet njerëzore, përfshirë kualifikimet profesionale dhe raportet bazë staf-përfitues;

- dh) kërkesat për infrastrukturën, pajisjet teknike dhe kushtet e sigurisë;
 - e) menaxhimin e rasteve, planifikimin e kujdesit dhe koordinimin e shërbimeve ndërdisiplinore;
 - ë) mbrojtjen e të dhënave personale, dokumentimin dhe ruajtjen e konfidencialitetit;
 - f) aksesueshmërinë, shëndetin, sigurinë, procedurat për identifikimin, dokumentimin dhe menaxhimin e incidenteve serioze, si dhe masat për gatishmërinë, reagimin dhe vazhdimësinë e shërbimeve në situata emergjente ose krizash;
 - g) indikatorët e performancës dhe mekanizmat e monitorimit, vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë, të cilët hartohen duke marrë në konsideratë karakteristikat, nevojat dhe situatën e përfituesve, sipas parimeve të barazisë, mosdiskriminimit dhe aksesit të barabartë në shërbime;
 - gj) kriteret dhe procedurat për vlerësimin e përmbushjes së standardeve dhe akreditimin e shërbimeve.
2. Standardet bazë të cilësisë dhe specifikimet e shërbimeve për çdo lloj shërbimi miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.
 3. Ofruesit e shërbimeve të kujdesit social janë të detyruar të zbatojnë standardet bazë të cilësisë gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të veprimtarisë së tyre.
 4. Ofruesit e shërbimeve sigurojnë mekanizma për marrjen e mendimit dhe vlerësimin e kënaqësisë së përfituesve dhe përdorin rezultatet e këtij vlerësimi për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve.
 5. Mosrespektimi i standardeve bazë të cilësisë përbën shkak për marrjen e masave administrative, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.

PJESA E KATËRT

PRANIMI, VLERËSIMI I NEVOJAVE, MENAXHIMI I RASTIT DHE LICENCIMI

KREU I

PROCEDURAT PËR PRANIMIN, VLERËSIMIN E NEVOJAVE DHE MENAXHIMIN E RASTIT

Neni 19

Pranimi në shërbimet e kujdesit social

1. Procedura e pranimi në shërbimet e kujdesit social fillon me paraqitjen e kërkesës nga individ, përfaqësuesi i tij ligjor, familjari, institucioni kompetent ose çdo subjekt tjetër i autorizuar me ligj.
2. Kërkesa paraqitet pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore përgjegjëse për vendbanimin ose vendqëndrimin e individit.
3. Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki regjistron kërkesën, hap dosjen dhe organizon vlerësimin e nevojave.
4. Në bazë të vlerësimit të nevojave, struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki merr vendim për:
 - a) ofrimin e shërbimit;
 - b) referimin në një shërbim tjetër;

- c) hartimin e planit individual të ndërhyrjes;
 - ç) marrjen e masave të tjera mbështetëse dhe ndërhyrjeve sociale të përshtatshme, sipas nevojave të vlerësuara të përfituesit dhe legjislacionit në fuqi.
5. Në rastet kur njësia e vetëqeverisjes vendore nuk disponon shërbimin e nevojshëm ose nuk ka kapacitete për ofrimin e tij, ajo siguron vendosjen e përfituesit në shërbimin më të afërt të disponueshëm në një njësi tjetër të vetëqeverisjes vendore. Përgjegjësia për koordinimin, ndjekjen dhe monitorimin e rastit mbetet pranë bashkisë që ka kryer vlerësimin e nevojave, pavarësisht vendndodhjes së shërbimit.
 6. Kur shërbimi organizohet në nivel qarku ose ofrohet nëpërmjet marrëveshjeve ndërbashkiake të koordinuara nga qarku, qarku mbështet bashkitë në organizimin e aksesit në shërbim, koordinimin institucional dhe përdorimin efikas të kapaciteteve rajonale, pa cenuar përgjegjësinë e bashkisë për vlerësimin, vendimmarrjen dhe ndjekjen e rastit.
 7. Në rastet emergjente, kur jeta, shëndeti ose siguria e individit janë në rrezik të menjëhershëm, bashkia siguron dhe dokumenton brenda 24 orëve mbrojtjen dhe mbështetjen e nevojshme, pa pritur përfundimin e procedurave të zakonshme.
 8. Procedurat e pranimit bazohen në parimet e aksesueshmërisë, trajtimit të barabartë, transparencës, pjesëmarrjes së përfituesit dhe përgjigjes në kohë.

Neni 20

Vlerësimi i nevojave

1. Vlerësimi i nevojave është procesi profesional i identifikimit dhe vlerësimit të nevojave për kujdes social të përfituesve potencialë, me qëllim përcaktimin e shërbimeve dhe masave të përshtatshme të mbështetjes.
2. Vlerësimi i nevojave do të kryhet nga punonjësi social i ngarkuar në Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, në bazë të kriterëve objektive dhe instrumenteve të standardizuara, me qasje multidisiplinore dhe të përqendruar te personi, duke marrë parasysh situatën, nevojat, mundësitë, kapacitetet, rreziqet dhe mjedisin e tij. Kur kujdesi ofrohet nga një kujdestar informal, vlerësimi mund të përfshijë edhe kapacitetet, kufizimet dhe nevojat e kujdestarit për mbështetje, me qëllim parandalimin e mbingarkesës së tij dhe sigurimin e vazhdimësisë së kujdesit.
3. Vlerësimi i nevojave organizohet dhe kryhet në mënyrë të integruar, duke marrë në konsideratë informacionin dhe vlerësimet e disponueshme nga strukturat përgjegjëse në fusha të ndryshme. Vlerësimet e specializuara të kryera në përputhje me legjislacionin përkatës integrohen në vlerësimin e përgjithshëm të nevojave dhe në përcaktimin e shërbimeve dhe masave të përshtatshme të mbështetjes, duke shmangur, sa është e mundur, përsëritjen e vlerësimeve.
4. Vlerësimi i nevojave përfshin, kur është e nevojshme, një vlerësim fillestar, gjithëpërfshirës, i specializuar ose emergjent, sipas natyrës dhe urgjencës së nevojave të përfituesit.
 5. Vlerësimi i nevojave përbën bazën për vendimet e pranimit, referimet dhe zhvillimin e planeve individuale të ndërhyrjes ose kujdesit, për përcaktimin e nivelit të prioritetit dhe intensitetit të shërbimit.
5. Vlerësimi i nevojave rishikohet periodikisht, në përputhje me procedurat standarde të çdo shërbimi, si dhe kur kërkohet nga ndryshime të rëndësishme në situatën sociale, familjare ose shëndetësore të individit.

6. Metodologjia, instrumentet dhe procedurat e vlerësimit të integruar të nevojave dhe menaxhimit të rastit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale, në përputhje me parimet, standardet dhe rregullat e përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 21

Menaxhimi i rastit

1. Menaxhimi i rastit është procesi profesional përmes të cilit vlerësohen nevojat e individit ose familjes dhe planifikohen, koordinohen, zbatohen, monitorohen dhe rishikohen ndërhyrjet dhe shërbimet e nevojshme, me qëllim sigurimin e plotësimit të nevojave, aksesit, vazhdimësisë dhe koherencës midis shërbimeve të kujdesit social dhe masave të tjera mbështetëse.
2. Menaxhimi i rastit në sistemin e shërbimeve të kujdesit social koordinohet nga struktura përgjegjëse për vlerësimin e nevojave dhe referimin në nivel vendor, nëpërmjet punonjësit social ose profesionistit të ngarkuar për menaxhimin e rastit, në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin përkatës.
3. Menaxhimi i rastit në sistemin e shërbimeve të kujdesit social koordinohet nga struktura përgjegjëse për vlerësimin e nevojave dhe referimin në nivel vendor, nëpërmjet punonjësit social ose profesionistit të ngarkuar për menaxhimin e rastit, në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin përkatës.
4. Menaxhimi i rastit bazohet në një plan individual të mbështetjes, të zhvilluar në bashkëpunim me individin dhe, kur është e përshtatshme dhe në përputhje me interesin më të mirë të tij, me familjen ose përfaqësuesin e tij ligjor.
5. Menaxhimi i rastit zbatohet përmes bashkëpunimit multidisiplinor dhe ndërinstitucional, kur natyra e nevojave të individit ose familjes kërkon ndërhyrje nga më shumë se një sektor ose ofrues shërbimi, duke siguruar integrimin dhe koordinimin e ndërhyrjeve dhe shërbimeve në përputhje me planin individual të mbështetjes.
6. Për rastet që janë subjekt i legjislacionit të posaçëm, menaxhimi i rastit kryhet në bashkëpunim dhe koordinim me strukturat dhe mekanizmat përgjegjës sipas legjislacionit përkatës, duke integruar në planin individual të mbështetjes ndërhyrjet dhe shërbimet e nevojshme dhe duke shmangur, sa është e mundur, mbivendosjen e funksioneve dhe përsëritjen e proceseve.
7. Menaxhimi i rastit siguron, sipas nevojave të individit ose familjes, planifikimin dhe koordinimin e tranzicioneve ndërmjet shërbimeve, institucioneve dhe fazave të ndryshme të jetës, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së mbështetjes.
8. Shkembimi i informacionit midis institucioneve kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
9. Rregullat, procedurat, standardet dhe instrumentet për vlerësimin, referimin dhe menaxhimin e integruar të rastit, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e strukturave dhe profesionistëve të përfshirë, përcaktohen me aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, në përputhje me legjislacionin sektorial.

KREU II

LICENCIMI

Neni 22

Licencimi i shërbimeve të kujdesit social

1. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit social i nënshtrohet licencimit në përputhje me legjislacionin në fuqi për licencimin.
2. Licencimi zbatohet për ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve të rkujdesit social të ofruara nga persona juridikë publikë dhe jopublikë.
3. Kriteret specifike, procedurat, dokumentacioni dhe kërkesat për licencimin e ofruesve të shërbimeve të kujdesit social miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për licencimin.
4. Licencimi zbatohet për të gjitha kategoritë dhe llojet e shërbimeve të kujdesit social të rregulluara nga ky ligj, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe shprehimisht nga një ligj i veçantë.

PJESA E PESTË

SIGURIMI I CILËSISË SË SISTEMIT TË KUJDEMIT SOCIAL

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 23 Sistemi i sigurimit të cilësisë

1. Sistemi i sigurimit të cilësisë së shërbimeve të kujdesit social synon garantimin e standardeve bazë të cilësisë, sigurisë dhe efektivitetit të shërbimeve për përfituesit.
2. Sistemi i sigurimit të cilësisë përfshin, ndër të tjera:
 - a) vendosjen dhe zbatimin e standardeve të cilësisë;
 - b) akreditimin e shërbimeve të kujdesit social, të ofruara nga ofrues publikë dhe jopublikë;
 - ç) mekanizmat e verifikimit të përputhshmërisë;
 - d) përdorimin e treguesve të performancës dhe sistemeve të raportimit, që mundësojnë matjen dhe analizimin e cilësisë dhe rezultateve të shërbimeve, sipas gjinisë dhe, kur është relevante dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas karakteristikave të tjera të përfituesve;
3. Akreditimi i shërbimeve të kujdesit social është mekanizëm i sigurimit të cilësisë dhe kryhet nga Agjencia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së kujdesit social.
4. Akreditimi është proces i veçantë nga licencimi. Licencimi përcakton të drejtën për ushtrimin e veprimtarisë, në bazë të përmbushjes së kërkesave dhe standardeve bazë, ndërsa akreditimi vlerëson dhe njeh përmbushjen e standardeve më të avancuara të cilësisë së shërbimit.
5. Akreditimi i shërbimeve të kujdesit social është vullnetar dhe përbën një mekanizëm të avancuar të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë, pa cenuar detyrimin për përmbushjen e standardeve bazë të cilësisë dhe kërkesat për licencim.
6. Standardet e cilësisë përshtaten dhe, sipas nevojës, diferencohen në varësi të llojit të shërbimit, kategorisë së përfituesve, natyrës dhe kompleksitetit të nevojave të tyre dhe mjedisit në të cilin ofrohet shërbimi.

7. Statusi i akreditimit të shërbimeve të kujdesit social publikohet dhe përditësohet periodikisht nga Agjencia përgjegjëse për sigurimin e cilësisë së kujdesit social, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
8. Kriteret, standardet, procedurat, metodologjia, vlefshmëria dhe rinovimi i akreditimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU II

MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PERFORMANCËS

Neni 24

Monitorimi i shërbimeve të kujdesit social

1. Monitorimi i shërbimeve të kujdesit social kryhet me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së tyre me standardet e cilësisë, legjislacionin në fuqi, standardet e cilësisë, objektivat e përcaktuara dhe rezultatet e arritura për përfituesit e shërbimeve.
2. Monitorimi i shërbimeve të kujdesit social publike dhe jopublike të financuara nga buxheti i shtetit realizohet nga struktura qendrore dhe rajonale të agjencisë përgjegjëse për shërbimet e kujdesit social, si dhe nga vetë strukturat monitoruese të bashkisë, për shërbimet e ngritura brenda territorit të tyre administrativ.
3. Procesi i monitorimit përfshin, ndër të tjera:
 - a) përcaktimin e objektivave dhe indikatorëve të matjes së rezultateve të shërbimeve
 - b) mbledhjen sistematike të të dhënave përmes vëzhgimit, raporteve, intervistave, pyetësorëve dhe dokumentacionit zyrtar dhe analizën e të dhënave mbi funksionimin e shërbimeve;
 - c) analizimin dhe vlerësimin e informacionit të mbledhur në raport me objektivat e përcaktuara;
 - ç) vlerësimin e përmbushjes së standardeve të cilësisë;
 - d) përdorimin e treguesve të performancës për vlerësimin e efektivitetit të shërbimeve dhe sipas natyrës së shërbimit, të rezultateve për përfituesit, përfshirë autonominë, cilësinë e jetës dhe përfshirjen sociale;
 - dh) raportimin periodik nga strukturat përgjegjëse për monitorimin në nivel qendror dhe vendor, sipas kompetencave të përcaktuara me ligj, përnjë ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, për ecurinë e sistemit të shërbimeve të kujdesit social;
 - d) hartimin e raporteve të monitorimit, duke përfshirë rekomandime për përmirësim të cilësisë së shërbimeve;
 - ë) mbledhjen dhe analizimin e informacionit nga përfituesit dhe, sipas rastit, familjarët e tyre, lidhur me cilësinë dhe aksesin në shërbime;
 - f) verifikimin e regjistrimit, raportimit dhe trajtimit të incidenteve serioze që cenojnë sigurinë, shëndetin ose të drejtat e përfituesve;
 - g) marrjen e masave për korrigjim dhe përmirësim bazuar në gjetjet e monitorimit.
4. Monitorimi i shërbimeve të kujdesit social realizohet sipas metodologjisë së miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale, si dhe në të dhënat e përpunuara nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Shërbimet Sociale (MIS) dhe mekanizmave të tjerë të raportimit institucional.

Neni 25

Raportimi dhe vlerësimi i performancës së shërbimeve

1. Ofruesit e shërbimeve të kujdesit social, publikë, jo publikë raportojnë periodikisht pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale të dhëna dhe informacion mbi funksionimin, ofrimin, aksesin dhe rezultatet e shërbimeve, sipas kërkesave të përcaktuara.
2. Strukturat përgjegjëse në nivel vendor përcjellin raportet e monitorimit dhe të dhënat përkatëse pranë strukturës përgjegjëse në nivel qendror, sipas kompetencave dhe procedurave të përcaktuara.
3. Raportet përdoren për:
 - a) planifikimin dhe zhvillimin e politikave sociale;
 - b) identifikimin e nevojave për shërbime të reja;
 - c) përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të shërbimeve ekzistuese.
4. Shërbimet, programet ose aspektet e veçanta të ofrimit të shërbimeve i nënshtrohen vlerësimeve periodike të jashtme.
5. Forma, përmbajtja, treguesit dhe periodiciteti i raportimit, si dhe procedurat e vlerësimit, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.

KREU III

INSPEKTIMI

Neni 26

Inspektimi i shërbimeve të kujdesit social

1. Inspektimi i shërbimeve të kujdesit social kryhet për të verifikuar përputhshmërinë e tyre me standardet e cilësisë, legjislacionin në fuqi dhe kushtet e licencimit, si dhe për garantimin e të drejtave, sigurisë dhe mirëqenies së përfituesve.
2. Inspektimi i shërbimeve të kujdesit social kryhet nga autoritetet përgjegjëse për inspektimin e shërbimeve të kujdesit social, sipas legjislacionit në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.
3. Inspektimi kryhet në mënyrë:
 - a) të planifikuar, bazuar në programe vjetore ose periodike të inspektimit;
 - b) të bazuar në risk, duke u orientuar drejt shërbimeve ose ofruesve me nivel më të lartë rreziku për sigurinë dhe të drejtat e përfituesve;
 - c) të papritur, në rastet e ankesave ose shqetësimeve serioze në lidhje me shërbimin, ose kur, bazuar në analizën e riskut, vlerësohet e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave, sigurisë, shëndetit dhe mirëqenies së përfituesve;
4. Inspektimet e papritura janë të detyrueshme për shërbimet rezidenciale për fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe personat e moshuar, në përputhje me një plan vjetor të bazuar në analizën e riskut.
5. Autoritetet e inspektimit hartojnë raporte inspektimi, përcaktojnë afatet për përmirësimin e rekomandimeve, si dhe rekomandojnë masat përkatëse për përmirësimin e shërbimeve ose për marrjen e masave administrative.
6. Inspektimi i shërbimeve të kujdesit social realizohet sipas metodologjisë së miratuar me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet sociale.
7. Ofruesit e shërbimeve janë të detyruar të sigurojnë aksesin e autoriteteve të inspektimit në

ambientet, dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për realizimin e inspektimit, duke respektuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 27

Masat korrigjuese dhe ndjekja e rekomandimeve

1. Në rast të konstatimit të shkeljeve gjatë inspektimit, autoriteti përgjegjës vendos masa korrigjuese proporcionale me natyrën, shkallën dhe rrezikun e shkeljes së konstatuar, për ofruesin e shërbimit.
2. Masat korrigjuese përfshijnë:
 - a) detyrimin për përmirësimin e kushteve të shërbimit;
 - b) përmirësimin e standardeve të sigurisë dhe cilësisë në përputhje me standardet e miratuara;
 - c) trajnimin dhe zhvillimin profesional të punonjësve;
 - ç) korrigjimin e dokumentacionit, rishikimin e procedurave dhe marrjen e masave të menjëhershme për mbrojtjen e përfituesve, në rastet kur konstatohet rrezik për shëndetin, sigurinë ose dinjitetin e tyre;
3. Ofruesi i shërbimit është i detyruar të zbatojë masat korrigjuese brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti i inspektimit.
4. Në rastet kur konstatohet rrezik i menjëhershëm për jetën, shëndetin ose sigurinë e përfituesve, autoriteti përgjegjës mund të urdhërojë masa të menjëhershme mbrojtëse, përfshirë kufizimin ose pezullimin e përkohshëm të aktivitetit, sipas legjislacionit në fuqi.
5. Moszbatimi i masave korrigjuese sjell marrjen e masave administrative, përfshirë, sipas rastit, pezullimin ose heqjen e licencës, sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.

KREU IV TRANSPARENCA

Neni 28

Transparenca dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë

1. Transparenca në funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit social sigurohet përmes informimit publik, pjesëmarrjes së përfituesve dhe përdorimit të informacionit të mbledhur për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve.
2. Ofruesit e shërbimeve raportojnë të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për funksionimin, aksesin, cilësinë dhe rezultatet e shërbimeve, sipas kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet në zbatim të tij. Informacioni i mbledhur përdoret për monitorimin, vlerësimin e performancës dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve.
3. Përfituesit e shërbimeve dhe, sipas rastit, organizatat e tyre përfaqësuese përfshihen në proceset e vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, nëpërmjet mekanizmave të konsultimit, marrjes së mendimit dhe pjesëmarrjes, sipas natyrës së shërbimit.

Neni 29

Publikimi i informacionit mbi cilësinë e shërbimeve

1. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe Agjensia përgjegjëse për shërbimet sociale sigurojnë transparencën e sistemit të shërbimeve të kujdesit social në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Agjensia përgjegjëse për shërbimet sociale është autoriteti përgjegjës për mbledhjen, pëpunimin, analizën dhe publikimin e të dhënave mbi performancën, cilësinë dhe funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit social, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me ligj.
3. Informacioni publik përfshin, ndër të tjera:
 - a) tipologjitë e shërbimeve;
 - b) rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit;
 - c) standardet e cilësisë dhe të drejtat e përfituesve dhe informacionet ose gjetjet kryesore mbi zbatimin e tyre;
 - ç) informacion të përditësuar mbi statusin e licencimit dhe akreditimit të shërbimeve;
 - d) informacion të përmbledhur mbi ankesat e paraqitura dhe gjetjet kryesore nga trajtimi i tyre, në mënyrë që të mbrohen të dhënat personale dhe konfidencialiteti i përfituesve.
4. Publikimi i informacionit realizohet përmes platformave zyrtare elektronike, në forma të aksesueshme dhe të kuptueshme për përfituesit dhe publikun, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit.
5. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale përdor raportet e Agjencisë përgjegjëse për shërbimet sociale për qëllime të hartimit dhe monitorimit të politikave sociale.

PJESA E GJASHTË

MENAXHIMI I INFORMACIONIT DHE TË DHËNAVE NË SISTEMIN E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SOCIAL

KREU I SISTEMI I MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT

Neni 30 Regjistri Elektronik Kombëtar i Shërbimeve Sociale

1. Regjistri Elektronik Kombëtar i Shërbimeve Sociale është sistemi kombëtar elektronik për regjistrimin, administrimin, menaxhimin e rasteve, përpunimin, shkëmbimin, përdorimin dhe raportimin e të dhënave të sistemit të shërbimeve sociale.
2. Regjistri Elektronik Kombëtar koordinohet dhe mbikëqyret nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe administrohet nga agjencia përgjegjëse për shërbimet sociale.
3. Përdorues të Regjistrimit Elektronik Kombëtar janë:
 - a) ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
 - b) agjencia përgjegjëse për shërbimet sociale;
 - c) Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
 - d) organi përgjegjës për inspektimin;
 - e) njësitë e vetëqeverisjes vendore;

- f) Ofruesit e licencuar të shërbimeve sociale kanë akses në Regjistrin Elektronik Kombëtar sipas niveleve të autorizimit të përcaktuara në përputhje me funksionet dhe përgjegjësitë e tyre
4. Çdo institucion ose ofrues i autorizuar është përgjegjës për saktësinë, plotësinë, përditësimin dhe ligjshmërinë e të dhënave që regjistron në Regjistrin Elektronik Kombëtar, në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi
 5. Agjencia përgjegjëse për shërbimet sociale siguron grumbullimin, verifikimin, administrimin dhe përpunimin e të dhënave, si dhe raportimin periodik pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale.
 6. Për qëllime monitorimi, vlerësimi dhe hartimi politikash sociale, të dhënat përpunohen dhe raportohen, sipas rastit, në formë të disagreguar sipas karakteristikave sociale dhe demografike relevante të përfituesve.
 7. Regjistri Elektronik Kombëtar funksionon në përputhje me legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore, ndërveprimin e sistemeve të informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
 8. Organizimi dhe funksionimi i Regjistrit Elektronik Kombëtar, procedurat për administrimin, si dhe nivelet e aksesit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 31

Përpunimi, mbrojtja dhe përdorimi i të dhënave

1. Aksesit dhe përpunimi i të dhënave që lidhen me përfituesit e shërbimeve sociale, veçanërisht personat në situata vulnerabiliteti, kryhet në përputhje me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kufizimit të aksesit sipas nevojës për përmbushjen e funksioneve ligjore
2. Institucionet përgjegjëse marrin masat e nevojshme teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë, konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave personale.
3. Përpunimi i të dhënave personale kryhet vetëm për qëllime të ligjshme dhe të përcaktuara qartë, në lidhje me:
 - a) ofrimin dhe administrimin e shërbimeve sociale;
 - b) menaxhimin e rasteve;
 - c) monitorimin dhe vlerësimin e sistemit të shërbimeve sociale;
 - ç) planifikimin, hartimin dhe vlerësimin e politikave sociale.
4. Të dhënat e administruara në Regjistrin Elektronik Kombëtar përdoren për:
 - a) planifikimin, hartimin dhe zhvillimin e shërbimeve sociale;
 - b) monitorimin dhe vlerësimin e sistemit dhe të shërbimeve sociale;
 - c) identifikimin e nevojave dhe planifikimin e shërbimeve;
 - ç) përmirësimin e cilësisë, efektivitetit dhe eficiencës së shërbimeve sociale.
5. Të dhënat përdoren për analiza statistikore dhe kërkime shkencore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kur qëllimi i përpunimit mund të arrihet pa identifikimin e subjekteve të të dhënave, përdoren të dhëna të anonimizuara.
6. Regjistri Elektronik Kombëtar funksionon në mënyrë të ndërveprueshme me sistemet e tjera elektronike shtetërore dhe sistemet përkatëse të informacionit në fushën e

mbrojtjes sociale dhe sektorëve të tjerë relevantë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Çdo subjekt i të dhënave gëzon të drejtat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

PJESA E SHTATË FINANCIMI, MENAXHIMI DHE KONTROLLI FINANCIAR

KREU I PARIMET DHE BURIMET E FINANCIMIT

Neni 32 Parimet e financimit

1. Financimi i shërbimeve synon garantimin e vazhdimësisë, qëndrueshmërisë dhe cilësisë së tyre.
2. Financimi i shërbimeve të kujdesit social bazohet në parimet e:
 - a) aksesit të barabartë dhe mosdiskriminimit;
 - b) orientimit sipas nevojave të përfituesve;
 - c) efikasitetit dhe përdorimit racional të burimeve publike;
 - ç) transparencës dhe llogaridhënies;
 - d) përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve.

Neni 33 Burimet e financimit

Shërbimet e kujdesit social, që ofrohen nga institucionet publike dhe jopublike, financohen nga burime publike dhe burime të tjera të ligjshme, si vijon:

- a) fondet e deleguara nga Buxheti i Shtetit, përfshirë fondin social dhe transfertat e tjera;
- b) Fondi Social Vendor;
- c) fondet nga buxhetet e njësisë të vetëqeverisjes vendore;
- ç) të ardhurat e caktuara nga pasuritë dhe veprimtari të tjera të bashkisë;
- d) kontributet dhe tarifatat e shërbimit për përfituesit e shërbimeve të kujdesit social, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) donacione, grante dhe financime nga partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

KREU II MEKANIZMAT E FINANCIMIT

Neni 34

Mekanizmat e financimit të shërbimeve të kujdesit social

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore planifikojnë, zhvillojnë, administrojnë dhe garantojnë ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve të kujdesit social brenda territorit të tyre.
2. Ministria përgjegjëse për shërbimet sociale planifikon, financon dhe siguron, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ofruesve të licencuar, shërbimet e specializuara me përgjegjësi kombëtare, të cilat për shkak të kompleksitetit, kostos ose nivelit të specializimit nuk mund të ofrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Llojet e këtyre shërbimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Financimi i shërbimeve të kujdesit social sigurohet nëpërmjet:
 - a) buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore;
 - b) transfertave nga buxheti i shtetit dhe transfertat e tjera të pakushtëzuara;
 - c) Fondit Social;
 - ç) burimeve të tjera të ligjshme të financimit.
4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore planifikojnë financimin e shërbimeve mbi bazën e vlerësimit të nevojave, prioritetëve vendore dhe kapaciteteve financiare.
5. Buxheti i shtetit kontribuon në financimin e shërbimeve të kujdesit social nëpërmjet transfertave për njësitë e vetëqeverisjes vendore, përfshirë:
 - a) fondin social të ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale;
 - b) transfertat e kushtëzuara dhe të pakushtëzuara për shërbime specifike;
 - c) forma të tjera financimi të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.
6. Shpërndarja e transfertave nga buxheti i shtetit bazohet në kritere objektive, duke marrë në konsideratë, të paktën:
 - a) vlerësimin e nevojave dhe nivelin e vulnerabilitetit;
 - b) numrin dhe profilin e përfituesve;
 - c) shtrirjen territoriale të njësisë së vetëqeverisjes vendore, numrin e njësive administrative, distancat gjeografike dhe kostot reale të aksesit dhe ofrimit të shërbimeve;
 - ç) kapacitetet vendore;
 - d) prioritetet kombëtare.
7. Ofrimi i shërbimeve të kujdesit social të financuara tërësisht ose pjesërisht nga fondet publike dhe të realizuara nga ofrues të licencuar publikë, jopublikë ose privatë, rregullohet nëpërmjet një marrëveshjeje financimi, e cila përcakton kushtet e financimit, standardet e shërbimit, treguesit e performancës, mënyrën e monitorimit dhe detyrimet e palëve.
8. Vijueshmëria e financimit vlerësohet në bazë të përmbushjes së treguesve të performancës, standardeve të cilësisë dhe rezultateve të arritura nga shërbimet, sipas kritereve dhe metodologjisë së përcaktuar.
9. Treguesit e performancës, mënyra e matjes së tyre, procedurat e monitorimit dhe rregullat për vlerësimin e vijueshmërisë së financimit përcaktohen me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale dhe ministrisë përgjegjëse për financat.
10. Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë ofrimin e shërbimeve të kujdesit social edhe nëpërmjet kontraktimit të ofruesve publikë, jopublikë ose privatë.

11. Në rast kontraktimi, përgjegjësia për sigurimin e vazhdimësisë, aksesueshmërisë, cilësisë dhe ligjshmërisë së shërbimit, si dhe për mbrojtjen e të drejtave të përfituesve, është e njësisë së vetëqeverisjes vendore.
12. Metodologjia e financimit të shërbimeve të kujdesit social për njësitë e vetëqeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 35 **Fondi social**

1. Programi i Fondit Social është mekanizëm financiar i programit buxhetor të ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale, i krijuar për të mbështetur njësitë e vetëqeverisjes vendore në zhvillimin, zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve të kujdesit social.
2. Fondi Social përdoret për:
 - a) zhvillimin e shërbimeve të reja të kujdesit social;
 - b) zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve ekzistuese;
 - c) mbështetjen e prioritetëve kombëtare në fushën e shërbimeve sociale;
 - ç) garantimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve të kujdesit social.
3. Përfitues të Programit të Fondit Social janë njësitë e vetëqeverisjes vendore.
4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të përdorin fondet e përfituara për ofrimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve ose për kontraktimin e ofruesve të licencuar të shërbimeve të kujdesit social, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Shpërndarja e fondeve bëhet në mënyrë transparente dhe konkurruese, mbi bazën e vlerësimit të nevojave objektive dhe prioritetëve të zhvillimit social të njësive të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me fondet e miratuara në buxhetin e shtetit dhe procedurat e përcaktuara. -
6. Kriteret, procedurat e financimit, metodologjia e shpërndarjes dhe përdorimit të Fondit Social miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III **KOSTOT DHE TARIFAT E SHËRBIMEVE**

Neni 36 **Kostot për njësi të shërbimeve të kujdesit social**

1. Financimi i shërbimeve të kujdesit social bazohet në metodologjinë e përcaktimit të koston për njësi shërbimi.
2. Kostoja për njësi shërbimi përcaktohet sipas tipologjisë së shërbimit, standardeve të ofrimit dhe nivelit të nevojave të përfituesve, në përputhje me parimet e transparencës, barazisë dhe efikasitetit.
3. Metodologjia për llogaritjen e koston për njësi shërbimi miratohet me urdhër të përbashkët të ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale dhe ministrisë përgjegjëse për financat.
4. Kostot referuese për shërbimet e kujdesit social miratohen me urdhër të përbashkët të ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale dhe ministrisë përgjegjëse për financat dhe

përditësohen periodikisht, sipas ndryshimeve të indeksit të çmimeve të publikuar nga Instituti i Statistikave.

5. Agjencia përgjegjëse për shërbimet sociale publikon dhe përditëson kostot referuese të shërbimeve të kujdesit social.

Neni 37

Tarifat dhe kontributet e përfituesve

1. Shërbimet e kujdesit social të financuara nga fondet publike ofrohen pa pagesë për kategoritë e përfituesve që plotësojnë kriteret e përfitimit të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Personat që nuk përfshihen në kategoritë e përfituesve të financuar nga fondet publike, por që pranohen në shërbimet e kujdesit social, në varësi të kapaciteteve të disponueshme, përfitojnë shërbimin kundrejt pagesës së tarifës përkatëse.
3. Tarifa përcaktohet duke marrë parasysh koston referuese të shërbimit, gjendjen socio-ekonomike dhe aftësinë paguese të personit dhe mund të jetë e plotë ose e reduktuar, sipas kriterëve të përcaktuara.
4. Kriteret për përcaktimin e tarifës së plotë ose të reduktuar, si dhe procedurat për vlerësimin e aftësisë paguese të personit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Rregulla të veçanta për tarifimin e shërbimeve të caktuara mund të përcaktohen duke mbajtur parasysh natyrën e shërbimit, kategorinë e përfituesve dhe garantimin e aksesit efektiv në shërbimet e përkujdesit shoqëror.

KREU IV

MENAXHIMI, RAPORTIMI DHE KONTROLLI FINANCIAR

Neni 38

Menaxhimi financiar dhe raportimi

1. Ofruesit e shërbimeve të kujdesit social që financohen, tërësisht ose pjesërisht, me fonde publike, sigurojnë menaxhim financiar në përputhje me parimet e ligjshmërisë, ekonomicitetit, eficiencës, efektivitetit, transparencës dhe llogaridhënies.
2. Ofruesit e shërbimeve të kujdesit social janë të detyruar:
 - a) të mbajnë regjistra financiarë dhe kontabël të saktë, të plotë dhe të verifikueshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - b) të përdorin fondet publike vetëm për qëllimet për të cilat janë akorduar;
 - c) të sigurojnë ndarjen dhe gjurmueshmërinë e përdorimit të fondeve publike sipas burimit të financimit dhe shërbimit të ofruar, si dhe dokumentimin e çdo shpenzimi;
 - ç) të respektojnë legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin, kontabilitetin dhe raportimin financiar.
3. Ofruesit dorëzojnë raporte periodike financiare dhe të performancës pranë autoritetit përgjegjës për financimin, në përputhje me kushtet, afatet dhe treguesit e përcaktuar në marrëveshjen e financimit dhe të performancës.
4. Format, përmbajtja, afatet, frekuenca dhe procedurat për raportimin financiar dhe të

performancës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet sociale, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për financat.

Neni 39

Kontrolli dhe auditimi

1. Ofruesit e shërbimeve të kujdesit social që financohen, tërësisht ose pjesërisht, me fonde publike, i nënshtrohen monitorimit, kontrollit financiar dhe kontrollit të rezultateve, si dhe auditimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të verifikuar përdorimin e rregullt të fondeve publike, përmbushjen e detyrimeve kontraktuale dhe arritjen e rezultateve të përcaktuara dhe standardeve të shërbimit.
2. Autoriteti kompetent, si dhe organet e tjera të ngarkuara me ligj, ushtrojnë kontroll dhe auditim mbi përdorimin e fondeve publike, sipas kompetencave të tyre.
3. Në rast të konstatimit të parregullsive, mosrespektimit të kushteve të financimit ose keqpërdorimit të fondeve publike, autoriteti kompetent, sipas rastit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, merr një ose më shumë nga masat e mëposhtme:
 - a) pezullimin e financimit;
 - b) rikuperimin e plotë ose të pjesshëm të fondeve të përdorura në kundërshtim me ligjin ose marrëveshjen e financimit;
 - c) vendosjen e masave administrative ose financiare, kur parashikohen nga legjislacioni në fuqi;
 - ç) zgjidhjen e marrëveshjes ose kontratës së financimit;
 - d) përjashtimin nga programet e financimit publik për një periudhë të përcaktuar në përputhje me kriteret dhe afatet e parashikuara në legjislacionin në fuqi.

PJESA E TETË

FORCA E PUNËS NË SHËRBIMET E KUJDESIT SOCIAL

KREU I

PROFESIONISTËT E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SOCIAL

Neni 40

Puna në fushën e shërbimeve të kujdesit social

1. Shërbimet e kujdesit social ofrohen nga profesionistë të kualifikuar dhe, sipas natyrës së profesionit, të certifikuar ose të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi për profesionet e rregulluara dhe kornizën kombëtare të kualifikimeve.
2. Ushtrimi i veprimtarisë profesionale në fushën e shërbimeve të kujdesit social bazohet në:
 - a) kualifikimet e njohura sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;
 - b) regjistrimin licencimin ose certifikimin, sipas natyrës së profesionit dhe legjislacionit në fuqi;
 - c) respektimin e standardeve profesionale dhe kodeve etike dhe kërkesave të cilësisë dhe sigurisë së shërbimit.
3. Ofruesit e shërbimeve të kujdesit social janë të detyruar të sigurojnë që shërbimet të ofrohen vetëm nga profesionistë që plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë ligj, dhe në legjislacionin e posaçëm që rregullon profesionin përkatës.

4. Kategoritë kryesore të figurave profesionale që angazhohen në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe parimet bazë të kualifikimit dhe kompetencave të tyre, përcaktohen në përputhje me llojin dhe natyrën e shërbimit.
5. Kriteret e detajuara të kualifikimit, certifikimit, regjistrimit, zhvillimit profesional dhe ushtrimit të veprimtarisë për kategoritë e figurave profesionale që nuk rregullohen nga legjislacioni i posaçëm përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 41

Kushtet për ushtrimin e profesionit

1. Profesionistët e shërbimeve të kujdesit social ushtrojnë profesionin në përputhje me kërkesat e përcaktuara për secilën figurë profesionale nga ky ligj dhe legjislacioni në fuqi.
2. Profesionistët që ushtrojnë profesione të rregulluara e ushtrojnë profesionin vetëm pasi të jenë pajisur me licencë individuale për ushtrimin e profesionit, sipas legjislacionit në fuqi për profesionet e rregulluara.
3. Profesionistët që nuk ushtrojnë profesione të rregulluara e ushtrojnë profesionin nëse plotësojnë kërkesat për arsimim, kualifikim profesional dhe, kur parashikohet, certifikim profesional, sipas këtij ligji dhe legjislacionit përkatës, si dhe kriterëve të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të tij.
4. Për figurat profesionale që nuk ushtrojnë profesione të rregulluara, certifikimi profesional, kur kërkohet, bazohet së paku në kriteret e arsimimit, kualifikimit, kompetencave profesionale dhe zhvillimit profesional të vazhdueshëm.
5. Kategoritë e figurave profesionale që i nënshtrohen certifikimit, kriteret dhe procedurat për certifikimin, si dhe autoriteti përgjegjës për këtë proces, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 42

Të drejtat dhe detyrimet e profesionistëve të shërbimeve të kujdesit social

1. Profesionistët e shërbimeve të kujdesit social ushtrojnë profesionin në përputhje me standardet profesionale, kodet e etikës dhe protokollet e shërbimit të miratuara sipas legjislacionit në fuqi.
2. Në ushtrimin e profesionit, profesionistët:
 - a) respektojnë dinjitetin, të drejtat, vullnetin dhe interesin më të mirë të përfituesit;
 - b) garantojnë konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale;
 - c) sigurojnë pjesëmarrjen e përfituesit në vendimmarrje, në përputhje me aftësitë dhe nevojat e tij;
 - ç) veprojnë me paanshmëri, integritet dhe përgjegjësi profesionale;
 - d) bashkëpunojnë në mënyrë ndërdisiplinore dhe ndërinstitutionale për ofrimin e shërbimeve të integruara;
 - dh) respektojnë standardet e cilësisë dhe dokumentojnë veprimtarinë profesionale sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
4. Profesionistët që ushtrojnë profesione të rregulluara i nënshtrohen edhe rregullave etike dhe disiplinore të urdhrave profesionalë përkatës.

5. Profesionistët që nuk ushtrojnë profesione të rregulluara i nënshtrohen mekanizmave të certifikimit, zhvillimit profesional, supervizimit dhe vlerësimit të performancës, sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
6. Ofruesit e shërbimeve të kujdesit social janë përgjegjës për garantimin e respektimit të standardeve profesionale dhe të cilësisë së shërbimeve, përmes mekanizmave të brendshëm të monitorimit, supervizimit profesional, vlerësimit periodik të performancës dhe zhvillimit profesional të personelit.
7. Profesionistët kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtarinë profesionale në kushte që garantojnë sigurinë, mbështetjen profesionale dhe mundësitë për zhvillim profesional.

Neni 43

Zhvillimi profesional i vazhdueshëm

1. Profesionistët e shërbimeve të kujdesit social janë të detyruar të ndjekin programe të zhvillimit profesional të vazhdueshëm, me qëllim ruajtjen, përditësimin dhe zhvillimin e kompetencave profesionale.
2. Zhvillimi profesional i vazhdueshëm organizohet:
 - a) nga urdhrat profesionalë për profesionet e rregulluara;
 - b) nga agjencia përgjegjëse për shërbimet e kujdesit social, në bashkëpunim me urdhrat profesionalë, institucionet e arsimit të lartë, institucionet e formimit profesional dhe subjektet e akredituara për figurat profesionale që nuk i përkasin profesioneve të rregulluara, në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë, institucionet e formimit profesional dhe subjektet e akredituara sipas legjislacionit në fuqi.
 - c) nga ofruesit e shërbimeve, nëpërmjet trajnimeve në vendin e punës, mentorimit, supervizimit dhe formave të tjera të zhvillimit profesional, në përputhje me nevojat e shërbimit dhe personelit.
3. Programet e zhvillimit profesional të vazhdueshëm përfshijnë edukimin në vazhdim, trajnimet profesionale, supervizimin, mentorimin dhe forma të tjera të zhvillimit të kompetencave profesionale.
4. Për profesionet e rregulluara, përmbushja e kërkesave të edukimit në vazhdim kryhet sipas legjislacionit në fuqi për profesionet e rregulluara.
5. Për figurat profesionale që nuk i përkasin profesioneve të rregulluara, përmbushja e kërkesave të zhvillimit profesional të vazhdueshëm përbën kusht për ruajtjen e vlefshmërisë së certifikimit profesional, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Zhvillimi profesional i vazhdueshëm dokumentohet dhe merret në konsideratë në vlerësimin periodik të performancës së profesionistëve.
7. Ofruesit e shërbimeve sigurojnë kohën dhe kushtet e nevojshme që profesionistët të përmbushin kërkesat e zhvillimit profesional të vazhdueshëm.
8. Agjencia përgjegjëse për shërbimet e kujdesit social, në bashkëpunim me urdhrat profesionalë dhe aktorët e tjerë relevantë, harton kuadrin orientues për zhvillimin profesional të vazhdueshëm të figurave profesionale që nuk i përkasin profesioneve të rregulluara.

Neni 44

Supervizimi profesional

1. Profesionistët e shërbimeve të kujdesit social kanë të drejtë dhe detyrim të përfitojnë supervizim profesional gjatë ushtrimit të profesionit.
2. Supervizimi profesional organizohet nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit social në përputhje me standardet e miratuara nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.
3. Supervizimi profesional synon garantimin e cilësisë së shërbimeve, zhvillimin e kompetencave profesionale, respektimin e standardeve etike dhe mbështetjen profesionale të personelit.
4. Mënyra e organizimit të supervizimit profesional dhe kriteret për supervizorët përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Supervizimi profesional organizohet në mënyrë të përshtatshme me natyrën, madhësinë dhe organizimin e ofruesit të shërbimit, duke garantuar akses në supervizim edhe për profesionistët që ushtrojnë veprimtarinë individualisht ose pranë ofruesve me numër të kufizuar punonjësish.

KREU II

MENAXHIMI DHE MIRËQENIA E FORCËS SË PUNËS

Neni 45

Administrimi i të dhënave për profesionistët e shërbimeve të kujdesit social

1. Agjencia përgjegjëse për shërbimet e kujdesit social administron, në kuadër të Sistemit Elektronik të Informacionit për Shërbimet e kujdesit Social, të dhënat mbi profesionistët e angazhuar në ofrimin e këtyre shërbimeve.
2. Të dhënat sigurohen nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit social, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe autoritetet kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Administrimi i këtyre të dhënave ka për qëllim planifikimin e burimeve njerëzore, monitorimin e kapaciteteve profesionale, zhvillimin e politikave në fushën e shërbimeve të kujdesit social dhe mbështetjen e proceseve të licencimit, certifikimit, monitorimit dhe inspektimit.
4. Administrimi i të dhënave sipas këtij neni nuk cenon kompetencat e urdhrave profesionalë për mbajtjen e regjistrave të profesionistëve të profesioneve të rregulluara dhe kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 46

Mbrojtja e shëndetit dhe mirëqenies së punonjësve

1. Institucionet publike dhe jopublike, që ofrojnë shërbime të kujdesit social janë të detyruara

- të garantojnë kushte të sigurta dhe të shëndetshme pune për personelin, në përputhje me legjislacionin për sigurinë dhe shëndetin në punë.
2. Punonjësit e shërbimeve të kujdesit social kanë të drejtë për mbrojtje nga mbingarkesa në punë, stresi i zgjatur në punë, rraskapitja profesionale dhe rreziqet psikosociale që lidhen me natyrën e ushtrimit të profesionit.
 3. Institucionet publike dhe jopublike janë përgjegjëse për marrjen e masave për;
 - a) menaxhimin e ngarkesës në punë dhe organizimin efektiv të shërbimeve;
 - b) promovimin e mirëqenies profesionale dhe zhvillimit të qëndrueshëm të personelit;
 - c) ofrimin e mbështetjes psikologjike për personelin dhe supervizimit profesional;
 4. Autoritetet përgjegjëse monitorojnë zbatimin e standardeve të mirëqenies në punë dhe ndërhyjnë në rast shkeljesh, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

PJESA E NËNTË LLOGARIDHËNIA DHE MJETET E MBROJTJES

KREU I E DREJTA PËR ANKIM DHE SHQYRTIMI I ANKESAVE

Neni 47 E drejta për ankim

1. Çdo përfitues i shërbimeve të kujdesit social, përfaqësuesi ligjor, kujdestari ose çdo person tjetër i autorizuar sipas ligjit ose nga përfituesi, përfshirë personin e besuar prej tij, ka të drejtë të paraqesë ankesë lidhur me cilësinë, aksesin, trajtimin, respektimin e të drejtave ose çdo aspekt tjetër të ofrimit të shërbimeve të perkujdesit shoqëror.
2. Ankesa mund të paraqitet pranë ofruesit të shërbimit, njësisë së vetëqeverisjes vendore, Agjencisë përgjegjëse për shërbimet e kujdesit social ose strukturave të tjera përgjegjëse, sipas fushës së përgjegjësisë.
3. Kur një ankesë paraqitet pranë një autoriteti që nuk është kompetent për shqyrtimin e saj, ajo i përcillet pa vonesë autoritetit kompetent dhe ankuesi njoftohet për përcjelljen. Kur e njëjta ankesë paraqitet pranë më shumë se një autoriteti, autoritetet bashkërendojnë shqyrtimin e saj për të shmangur shqyrtimin e dyfishtë ose marrjen e vendimeve kontradiktore.
4. Paraqitja e ankesës nuk mund të sjellë pasoja të pafavorshme për përfituesin e shërbimit dhe garanton mbrojtjen e tij nga çdo formë diskriminimi, hakmarrjeje ose trajtimi të padrejtë. E drejta për paraqitjen e ankesës sipas këtij neni nuk cenon të drejtën e përfituesit për të ushtruar ankimin administrativ ose për t'iu drejtuar gjykatës, sipas legjislacionit në fuqi.
5. E drejta për ankesë sipas këtij neni nuk cenon të drejtën e ankimit administrativ ndaj akteve administrative, sipas këtij ligji dhe Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 48 Procedura e shqyrtimit të ankesave

1. Ofruesit e shërbimeve të kujdesit social krijojnë dhe zbatojnë mekanizma të brendshëm për pranimin, regjistrimin, trajtimin dhe shqyrtimin e ankesave të përfituesve të shërbimeve.
2. Ofruesi i shërbimit, njësia e vetëqeverisjes vendore, Agjencia përgjegjëse për shërbimet e kujdesit social dhe çdo autoritet tjetër kompetent, shqyrtojnë ankesat brenda fushës së tyre të përgjegjësisë në mënyrë të paanshme, transparente dhe brenda një afati të arsyeshëm, por jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së ankesës, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj.
3. Përfituesi informohet me shkrim për rezultatin e shqyrtimit të ankesës, masat e marra dhe, kur është rasti, mënyrën e mëtejshme të ndjekjes së çështjes.
4. Kur ankesa lidhet me cenimin e sigurisë, integritetit fizik ose psikologjik të përfituesit, ajo shqyrtohet me procedurë të përsheptuar, sipas rregullave të përcaktuara në aktet në zbatim të këtij ligji.
5. Procedurat për administrimin dhe shqyrtimin e ankesave përfshihen në standardet bazë të cilësisë së shërbimeve të kujdesit social.

KREU II

SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 49

Shkeljet administrative dhe masat administrative

1. Shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.
2. Struktura përgjegjëse për inspektimin e shërbimeve të kujdesit social, në zbatim të përgjegjësisë të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, vendos masat administrative si më poshtë:
 - a) ndaj ofruesve jopublikë të shërbimeve të kujdesit social, për shkeljen e detyrimeve që lidhen me respektimin e standardeve të shërbimit, të drejtave të përfituesve, kushteve të licencimit dhe kërkesave të tjera ligjore, vendos gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë për shkeljet e lehta ose të mesme dhe nga 100 000 deri në 500 000 lekë për shkeljet e rënda, sipas natyrës, rëndësisë, pasojave dhe përsëritjes së shkeljes. Për shkeljet që paraqesin rrezik të menjëhershëm ose serioz për jetën, shëndetin, sigurinë ose integritetin e përfituesit, zbatohen edhe masat e parashikuara në këtë ligj për kufizimin ose pezullimin e aktivitetit dhe, sipas rastit, të licencës.
 - b) për shkeljet e kryera nga punonjësit e institucioneve publike zbatuese të këtij ligji, i drejtohet institucionit përgjegjës për fillimin e procedimit disiplinor, sipas legjislacionit të zbatueshëm për marrëdhëniet e punës ose shërbimin civil;
 - c) për shkeljet që lidhen me procedurat e financimit dhe prokurimit publik, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për menaxhimin financiar dhe prokurimin publik;
 - ç) kërkon marrjen e masave për korrigjimin e shkeljes dhe, kur është shkaktuar dëm, njofton ose referon çështjen pranë autoritetit kompetent për ndjekjen e përgjegjësisë dhe shpërbimin e dëmit, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Struktura përgjegjëse për inspektimin e shërbimeve të kujdesit social kryen inspektime edhe mbi bazën e gjetjeve të monitorimeve të kryera nga Agjencia përgjegjëse për shërbimet e kujdesit social.
4. Kur gjatë ushtrimit të veprimtarisë së inspektimit konstatohen elemente të një vepre penale, struktura përgjegjëse për inspektimin e shërbimeve të kujdesit social bën kallëzim pranë autoriteteve kompetente.
5. Shkeljet lidhur me administrimin dhe përdorimin e fondeve publike të destinuara për shërbimet e kujdesit social, kur nuk përbëjnë vepër penale, trajtohen sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin financiar publik dhe kundërvajtjet administrative.
5. Kundër masave administrative të vendosura nga struktura përgjegjëse për inspektimin e shërbimeve të kujdesit social bëhet ankimi sipas legjislacionit në fuqi për inspektimin.
6. Të ardhurat nga gjrobat e vendosura sipas këtij neni derdhen në Buxhetin e Shtetit.

KREU III ANKIMI

Neni 50 Ankimi administrativ

1. Kërkuesi ose përfituesi i shërbimeve të kujdesit social, kur pretendon se një akt administrativ i nxjerrë në zbatim të këtij ligji cenon të drejtat ose interesat e tij të ligjshme, ka të drejtë të paraqesë ankimi administrativ pranë organit kompetent, brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për aktin administrativ, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.
2. Organi kompetent shqyrton ankimin administrativ dhe njofton ankuesin për vendimin e marrë brenda afatit të përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative.
3. Në rast se ankimi administrativ paraqitet ndaj një vendimi të njësisë së vetëqeverisjes vendore, ankimi shqyrtohet sipas strukturës kompetente të përcaktuar në legjislacionin në fuqi.
4. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës ushtrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 51 E drejta për t'iu drejtuar gjykatës

1. Përfituesit e shërbimeve të kujdesit social, ofruesit e shërbimeve dhe personat e tjerë që kanë interes të ligjshëm kanë të drejtë të kundërshtojnë aktet administrative, veprimet ose mosveprimet e organeve publike të marra në zbatim të këtij ligji, në gjykatën kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Padia në gjykatën administrative, kur mosmarrëveshja është në juridiksionin administrativ, paraqitet pas shterimit të mjeteve administrative të ankimit, përveç rasteve të parashikuara nga ligji.

PJESA E DHJETË DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

KREU I

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 52 Masat kalimtare

1. Ofruesit e shërbimeve të kujdesit social që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë të operojnë për një periudhë kalimtare, deri në përshtatjen e tyre me kërkesat dhe standardet e përcaktuara në këtë ligj.
2. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ofruesit ekzistues të shërbimeve të kujdesit social duhet të përmbushin kushtet dhe kriteret e licencimit dhe të standardeve të cilësisë të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore përkatëse.
3. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe institucionet e përcaktuara në Kreun xxx marrin masat e nevojshme për përshtatjen graduale të sistemit të shërbimeve të kujdesit social me dispozitat e këtij ligji.
4. Shërbimet rezidenciale ekzistuese, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë të operojnë përkohësisht, duke iu nënshtruar procesit të transformimit gradual në përputhje me parimin e deinstitutionalizimit. Autoritetet përgjegjëse për shërbimet sociale në nivel qendror, rajonal dhe lokal, marrin masa për reduktimin progresiv të kapaciteteve rezidenciale dhe zhvillimin e alternativave të bazuara në komunitet dhe në familje, duke garantuar në çdo rast vazhdimësinë dhe cilësinë e kujdesit për përfituesit.

Neni 53 Masat kalimtare për transformimin e shërbimeve rezidenciale

1. Shërbimet rezidenciale ekzistuese, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë të operojnë përkohësisht, duke iu nënshtruar procesit të transformimit gradual në përputhje me parimin e deinstitutionalizimit.
2. Autoritetet përgjegjëse për shërbimet sociale në nivel qendror, rajonal dhe lokal, marrin masa për reduktimin progresiv të kapaciteteve rezidenciale dhe zhvillimin e alternativave të bazuara në komunitet dhe në familje, duke garantuar në çdo rast vazhdimësinë dhe cilësinë e kujdesit për përfituesit.

KREU II DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 54 Shfuqizimet

Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij shfuqizohen.

Neni 55 Aktet nënligjore

1. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet sociale për nxjerrjen e udhëzimeve në zbatim të neneve, të këtij ligji, brenda muajve nga hyrja në fuqi e tij.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit, pika, të këtij ligji brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 56
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

DRAFT